

## **STATUTI I SHOQËRISË “B Creative”shpk.**

### **Neni 1**

#### **Emri, Forma**

Shoqeria do të ketë emrin **“B Creative” shpk** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur me poshtë e “Shoqëria”.

### **Neni 2**

#### **Selia**

Shoqeria e ka selinë në adresë: : Rruga Peti Nr 153,Zena Kadastrale 3292,Numër pasurie 153/116+3N2 Kati I-re,Farke ,Tirane ”dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 3**

#### **Objekti i veprimtarise**

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqerinë **“B Creative”** është; shërbime marketingu brenda dhe jashtë Shqipërise.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(një) kuote, i cili zotërohet si më poshtë: Vjola Baze Blushi lindur në Tiranë me date 14 Maj 1987,identifikuar me karte identiteti me numer I75514079B,zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë.Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

### **Neni 6**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për

Vjola Blushi  
Key

detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### Neni 7

#### Organji Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "B Creative" shpk është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundershtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 8

#### Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përrpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 9

#### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e

Yola Blushi  
Holl

numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 10**

#### **Marrja e vendimeve**

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### **Neni 11**

#### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë “B Creative” është: Vjola Baze Blushi lindur në Tiranë me date 14 Maj 1987, identifikuar me karte identiteti me numer I75514079B. Administratori i shoqerisë është i emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 01.09.2021.

Asambleja e ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët i ushtrojnë kompetencat bashkë ose veç e veç.

### **Neni 12**

#### **Kompetencat**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthamat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Vjola Blushi  
ABG

### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

### **Neni 14 Bilanci i shoqërisë dhe dividentët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rrëth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 15**

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër.

### **Neni 16**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit:

### **Neni 17**

#### **Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi)**

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Vjola Blushi  
A. Blushi

**Neni 18**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohet ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 19**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund te lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 20**  
**Dispozita përfundimtare**

Statuti i shoqerise "**B Creative**" shpk u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**  
**Vjola Blushi**

Vjola Blushi  
Vjola Blushi

Tiranë, më datë 01.09.2021

Vjola Blushi  
Vjola Blushi